

**MENDIMI POLITIK I RILINDJES KOMBËTARE SHQIPTARE NË VITET E
REVOLUCIONIT KOMBËTAR SHQIPTAR (1909-1912)**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË HISTORI E KOHËS SË RE**

NGA

XHELAL KUÇI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

Qershor, 2021

EKspoZE E TEMËS

MENDIMI POLITIK I RILINDJES KOMBËTARE SHQIPTARE NË VITET E REVOLUCIONIT KOMBËTAR SHQIPTAR (1909-1912)

Mentori:

Prof. Dr. Gazmend Rizaj

Kandidati:

Xhelal Kuçi

Mendimi politik i Rilindjes Kombëtare Shqiptare në vitet e Revolucionit Kombëtar 1909-1912, ishte një nga fazat më të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Prandaj, ky punim i diplomës synon të përfshijë ngjarjet dhe faktet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me historinë e mendimit politik - historik të shtetit shqiptar gjatë viteve 1909 – 1912 që kanë ndikuar në ndërtimin e diplomacisë dhe reflektimit të saj në arenën ndërkombëtare.

Epoka e Rilindjes karakterizohet nga zhvillimi i një ideologjie e kulture të re me karakter kombëtar e demokratik, nga përpjekjet që rilindësit e shquar bënë për ruajtjen dhe lëvrimin e gjuhës shqipe, për zhvillimin e letërsisë dhe çeljen e shkollave në gjuhën amtare. Në këtë periudhë të Rilindjes mori hov zhvillimi i mendimit politik, shoqëror, e filozofik që u përpunua nga iluministët e mendimtarët më të shquar në bazë të përgjithësimin të përvojës së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ky mendim politik e shoqëror dhe në tërësi programi politik i Rilindjes u përgjigjeshin detyrave të bashkimit e të çlirimit kombëtar, që objektivisht shtroheshin për zgjidhje para shoqërisë shqiptare. Por, ato karakterizoheshin, gjithashtu, nga një frymë e theksuar demokratike, shprehnin aspiratat e gjithë popullit për liri, pavarësi dhe përparim ekonomik-shoqëror e politik të vendit.

Për hartimin e këtij studimi, që është një plotësim modest i kësaj mungese, përveç që është shfrytëzuar literaturë nga autorë shqiptarë dhe të huaj, është shfrytëzuar pastaj edhe shtypi demokratik që dilte në periudhën e Rilindjes Kombëtare. Po ashtu, janë shfrytëzuar edhe arkivat kryesisht të pa botuar, arkivat dhe bibliotekat shkencore, si dhe fondet e koleksionet arkivale që trajtojnë këtë çështje.

Megjithë përpjekjet maksimale për t'i shterruar burimet e literaturën e duhur, me qëllim që ndriçimi i kësaj çështjeje të jetë sa më i plotë e më i gjithanshëm, jetojmë të bindur se ka mbetur mjaft punë edhe për hulumtime të tjera.

Qëllimi

Qëllimi i hulumtimit për të realizuar këtë punim është që të trajtojmë në frymën e shkencës së historisë “Mendimi politik i Rilindjes Kombëtare shqiptare në vitet e Revolucionit Kombëtar Shqiptar 1909-1912”.

Që kjo punë të jetë sa më e tërësishme, jemi nisur nga mendimi politik i Rilindjes Kombëtare Shqiptare në vitet e Revolucionit Kombëtar Shqiptar 1909-1912. Sa i përket temës që unë e kam marrë për studim, do të mundohem që për këtë periudhë të bëj analiza në bazë të hulumtimeve dhe literaturës që do të posedoj, do të mundohem të sjellë në pahë gjëra të vërteta dhe të qëndrueshme, do të bëj hulumtime në mënyrë që të shfrytëzoj sa më shumë burime të dorës së parë.

Metodat dhe objektivat e studimit

Metodologjia që është përdorur për realizimin e këtij punimi bazohet në shfrytëzimin dhe kombinimin e të dhënave të ndryshme. Sigurimi i këtyre të dhënave është mundësuar nëpërmjet literaturës së mendimit politik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Sa i përket metodologjisë hulumtuese, mund të themi se një nga tipet më të rëndësishme është hulumtimi shkencor - historik. Ndërsa për të finalizuar këtë punim diplome janë ndjekur kryesisht metodat deskriptive, krahasuese, metoda e analizës, metoda e hulumtimit (anketa, intervista) etj.

Metoda deskriptive përshkruan natyrën e marrëdhënies ndërmjet variablave të qëllimshme, pa shikuar shkak apo efekt.

Metoda krahasuese nënkupton krahasimin e dy apo më shumë objekteve të studimit duke konstatuar ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes tyre.

Metoda e analizës është objekti ndaj të cilit merret informacion në kuadër të një studimi të dhënë. Njësia e analizës, pra objekti mund të jetë individ (**respondent**), nëse kemi të bëjmë me anketime apo intervista, por mund të jetë edhe institucion, shtet apo qytet, kjo varet nga studimi që do të kryhet.

Metoda e hulumtimit është përdorur për shfrytëzimin e të gjithë literatures ekzistuese mbi mendimin politik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Janë shfrytëzuar botime të ndryshme të studiuesve vendas dhe të huaj në lidhje me mendimin politik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Anketa është një fushë e statistikave të aplikuara që studion nxjerrjen e mostrave të njësive individuale nga një popullatë dhe teknikat e mbledhjes së të dhënave, të tilla si ndërtimi i pyetësorit dhe metodat për përmirësimin e numrit dhe saktësisë së përgjigjeve ndaj anketave.

1. Organizimi i punimit

Ky punim masteri është strukturuar në pesë kapituj kryesorë të ndarë në disa nënkapituj. Secili prej tyre trajton çështje të veçanta me synim përmbushjen e objektivave. Me gjithë përpjekjet dhe punën e mundimshme për të pëfshirë të dhënat kryesore të temës së paraparë me projektin ideor jam i vetëdijshëm se ka akoma për t'u bërë në këtë fushë, që ndoshta ndonjëherë në të ardhmen në ndonjë punim tjetër do t'u rikthehem dhe do t'i plotësoj më shumë. Shpresoj se ia kam arritur sado pak qëllimit të jap një këndvështrim modest për rolin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare gjatë periudhës së vitit 1909-1912.

Kapitulli I trajton mendimin politik të rilindësve shqiptarë Sami Frashërit dhe Ismail Qemalit, si dhe veprimtarinë diplomatike parlamentare të Hasan Prishtinës dhe Programin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare gjatë periudhës së viteve 1909-1912.

Kapitulli II trajton ndërlidhjen e identitetit etnik me atë kombëtar dhe emancipim, luftën për statusin e kombit dhe shpërputhjet e para midis islamizmit dhe shqiptarizmit.

Kapitulli III trajton revolucionin xhonturk dhe rolin e shqiptarëve në të, përputhjet, interesat e përbashkëta midis shqiptarëve dhe xhonturqëve, si dhe kundërshtimet dhe konfliktet e hapura deri në armiqësi midis shqiptarëve dhe xhonturqve.

Kapitulli IV trajton rolin e tyre në krijimin e mendimit politik për çështjen shqiptare si dhe angazhimi i shoqërive patriotike në hapjen e shkollave shqipe dhe përkthimin e teksteve.

Kapitulli V trajton mendimet politike të akterëve të kohës rreth statusit të Shqipërisë, rëndësinë e shpalljes së pavarësisë dhe ndikimin në arenën ndërkombëtare si dhe argumentimin e palës shqiptare në mbrojtjen e pavarësisë në kanceleritë evropiane.

Për fund, dua të falënderoj Mentorin tim Prof. Dr. Gazmend Rizaj, jo vetëm për ndihmën dhe udhëzimet e dhëna, por edhe për lirinë akademike të ofruar gjatë përgatitjes dhe finalizimit të projektit.